



institute for war & peace reporting

[About IWPR](#) | [Publications](#) | [Programmes](#) | [Opportunities](#) | [Contact Us](#)

Thursday, April 25, 2002



Balkan Crisis Report

rem:ca

- > [Afghanistan](#)
- > [Central Asia](#)
- > [Balkans](#)
- > [Tribunal](#)
- > [Caucasus](#)
- > [Training](#)
- > [Conflict Reports](#)
- > [Books](#)
- > [Letters](#)
- > [Search](#)
- > [Archive](#)
- > [Links](#)

SHQIPERI: SHKATERRIMI I RRJETIT TE PROSTITUCIONIT

Disa individe te guximshem po luftojne trafikun e vajzave i cili po shkaterron komunitetet rurale.

Nga Agim Kanani ne Tirane.

Ne sallën e mberritjeve ne Aeroportin Nderkombetar te Rinasit, disa vajza te reja Shqiptare nxitojne te kalojne duke treguar edhe disa shenja te rrahjeve nga tutoret e tyre. Ato jane gjendur ne rrjeten e prostitucionit nderkombetar. Ato sapo kthehen ne vendin e tyre, nisen perseri per ne lagjet e prostitucionit ne Europen Perendimore.

Keto vajza nuk kane shume dëshire te flasin, dhe aq me pak te shpjegojne shenjat e rrahjeve. "Kam bere nje aksident me makine," thote njera prej tyre e cila nuk ka dy dhembe dhe ka nje shenje ne faqe. Nje tjetër, e quajtur Silvana, nuk shpjegon rreth nje shenje ne buze dhe nje te nxire ne nofull. Nje tjetër vajze me demtime te ngjashme thote: "U pengova dhe u rrezova ne banjo".

Agjensite e ndihmave llogarisin se rreth 30,000 Shqiptare punojne si prostituta ne te gjithë Europen. Ato perbejne pothuajse nje perqind te popullsisë se Shqiperise. Te pakten 60 perqind e tyre jane femije, pjesa me e madhe te rrembyera apo te mashtruar per te prostituar, ne nje nder rrjetet me te medha te prostitucionit ne kontinent.

"Mos prit te te thone te verteten," thote nje polic i aeroportit. "Te gjitha ato qe kthehen duan te shkojne perseri ne Itali. Kjo jo vetem per shkak te kercenimeve te tutoreve te tyre, por sepse shume nga familjet nuk i pranojne me. Njera prej tyre me ka thene ' Nuk dua te kthehem ne shtepi sepse babai do te me rrahe".

Keto vajza kane pak mundesi reintegrimi ne Shqiperi. Ne pjesen e caktuar per Shqiperine ne raportin vjetor te Departamentit Amerikan te Shtetit thuhet se ato perballen me "nje stigmatizim te madh nga familjet dhe shoqeria". Raporti vazhdon: "Per shkak te problemit te madh te trafikimit dhe burimeve te pakta per reintegrimin e tyre, pjesa me e madhe e viktimave nuk perfitojne asnje lloj ndihme".

Shume police te kontrollit kufitar nuk kane asnje lloj keqardhje per keto vajza, duke i konsideruar ato si kriminele dhe jo si viktime. Sapo ato zbresin nga avionet, shumica pergatiten per'u kthyer ne Itali me ane te skafeve klandestine. Kushdo mund te siguroje nje vend ne te nese ka shumen e nevojeshme te parave, sepse vetem nga qyteti port i Vlores nisen odo nate 10 deri 15 syresh.

Past Reports

2002	Issues
Mar	322-327
Feb	314-321
Jan	307-313
2001	Issues
Dec	302-308
Nov	293-301
Oct	285-292
Sep	277-284
Aug	267-276
Jul	261-266
Jun	252-260
May	243-251
Apr	233-242
Mar	223-232
Feb	214-222
Jan	207-213

2000 - 1999

En français:

'02 | '01 | '00 | '99



Resource Pages



- [Albania](#)
- [Bosnia & Herzegovina](#)
- [Croatia](#)
- [Kosovo](#)
- [Macedonia](#)
- [Montenegro](#)
- [Romania](#)
- [Serbia](#)
- [Slovenia](#)

Related Links

- [Albanian-language Media](#)
- [Blue Sky Radio, Kosovo](#)
- [Central Europe Online - Balkans Today](#)

që deshirojnë të dalin nga rrjeti i prostitucionit dhe të reintegrohen në komunitetin e tyre. Qendra të tilla sekrete janë hapur në Tiranë dhe Vlorë. Në Fier, në qendër të Shqipërisë, shefi i policisë lokale, Xhavit Shala, ka ndertuar një qendër të thjeshtë për strehimin e këtyre viktimave të trafikut brenda territorit të policisë.

"Shqiptaret duhet të mesojnë të trajtojnë këto vajza si viktime dhe jo si prostituta," thotë Shala. I cili është i vendosur të luftojë pushtetin e trafikanteve. Ai organizon takime me mesues, drejtues të biznesëve dhe banorë për të shpjeguar se si trafiku i vajzave po shkatërron jetën në fshatra.

Rezultatet kanë qenë të habitshme. Ankimet kundër tutorëve dhe trafikanteve janë rritur me pothuajse 400 përqind. Shala ka ngritur qendrën e strehimit të viktimave Brenda territorit të komisarariatit, ndërsa policia kryen hetimet e nevojshme rreth tutorëve.

Kur qeveria nuk pranoi të financojë këto strehez, ai arriti të mbledhë 18,000 dollarë Amerikanë nga komuniteti lokal i biznesit. Brenda tre kontejnerëve metalikë gjenden disa krevate marinar dhe disa tavolina shkolle. Por dhomat janë të pastra dhe rrjeta e telit rrethon një oborr të vogël.

Shala përballët me një problem të madh. Disa prej vajzave për të cilat ai kujdeset largohen sepse gjykatat vonojnë shumë në gjykimin e tutorëve të tyre. Ai i ka kërkuar ministritë se drejtësisë të shpejtojnë procedurat por nuk ka marrë ende asnjë përgjigje.

Autoritetet nuk kanë pranuar gjithashtu të paguajnë për ushqimin e vajzave në këto qendra. "Une nuk u kërkoj me ndihmë zyrtareve," thotë Shala. "Une u kërkoj atyre vetëm të mos na pengojnë në rrugën tonë".

Qendra e tij përpiqet të binde familjet e vajzave të pranojnë ato perseri në gjirin e tyre. "Ne u themi atyre që nuk është vetëm faji i vajzave që kanë rënë në rrjetin e prostitucionit por edhe i tyre," shpjegon Shala. "Statistikat tregojnë se vajzat e tyre janë mashtruar për të hyrë në prostitucionin. Ne i pyesim familjet se përse kanë lejuar që vajzat e tyre të bienë viktime".

Që prej hapjes së tij, projekti i Vlores ka ndihmuar 40 vajza dhe ka bashkuar shumicën e tyre me familjet.

Por drejtuesja e qendres, e cila kërkon të mos përmendet me emër, thotë se influenca e tutorëve nuk duhet nënvlefësuar asnjë herë dhe se ajo vetë është kërcënuar. "Kjo punë me ka tmerruar," thotë ajo.

Edhe kur familjet i pranojnë vajzat e tyre, kjo nuk është zakonisht një zgjidhje afatgjate. "Disa herë une shkoj për të parë vajzat dhe nuk i gjej me në shtëpi," vështron ajo. "Vajzat e trafikuar në këto mënyrë kanë pak shpresë për të rifilluar një jetë normale".

Agim Kanani është një gazetar i pavarur në Tiranë.

[Human Rights Watch](#)

[Intl Crisis Group](#)

[Kosovo Press](#)

[Lawyers Committee for Human Rights](#)

[Orthodox Church, Kosovo](#)

[OSCE](#)

[Serbian Information Ministry](#)

[UNMIK](#)

[US State Dept](#)

[World Press Review](#)

[Yahoo! News/Kosovo](#)

[YU-Media](#)

Support

For work in the Balkan region IWRP gratefully acknowledges support from:

